


Buletini

TEMAT KRYESORE



ENTSO-E dhe KOSTT	3
Nënshkruhet Marrëveshja e Interkoneksionit në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri si dhe Marrëveshja për implementimin e projektit të linjes interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri	4
KOSTT vazhdon procesin e vendosjes së sistemit të standardizuar të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008	5
Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit ekzistues, KOSTT realizon mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit transmetues	8
Lajm shkurt Konstituohet Bordi i Drejtorëve të KOSTT	11



PËRMBAJTJA

ENTSO-E dhe KOSTT	3	
Nënshkruhet Marrëveshja e Interkoneksionit në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri si dhe Marrëveshja për implementimin e projektit të linjes interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri	4	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut -KOSTT sh.a - është kompani publike e cila merret me planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë. KOSTT është përgjegjës për transmisionin e energjisë elektrike të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV dhe po ashtu është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregimit të energjisë elektrike.
Aprovohen tarifat e ngarkesës për KOSTT sh.a për vitin 2009	5	
KOSTT vazhdon procesin e vendosjes së sistemit të standardizuar të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008	5	
Prezantohen planet për zhvillimin e afatmesëm të kapaciteteve të transmisionit	6	MISIONI
Përfundon projekti për riparimin e linjës 110 kV NS Deçan-NS Gjakovë	7	Të siguroj:
Takim i bashkëpunimit teknik në mes të KOSTT sh.a dhe Transmisionit të Malit të Zi TSO-EPCG	7	<ul style="list-style-type: none"> shërbime cilësore duke implementuar të arritura tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit; transparencë dhe jo-diskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike; avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.
Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit ekzistues, KOSTT realizon mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit transmetues	8	VISIONI
Amandamentohet Neni 3.2 dhe Neni 17.4.2.2 i Kodit të Pajisjeve Elektrike	9	Të jetë kompani profitabile, për transmetimin e sigurt dhe stabil të energjisë elektrike, e përgjegjës ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropian.
Vendimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRR) gjatë muajve Janar, Shkurt, Mars dhe Prill 2009	9	
Panairi Ndërkombëtar i Teknologjisë dhe Cilësisë	10	
Lajm shkurt Konstituohet Bordi i Drejtorëve të KOSTT	11	
KOSTT në Numra	11	



Fadil Ismajli, Drejtor menaxhues

ENTSO-E dhe KOSTT

Anëtarë të ENTSO-E me automatizëm do të jenë të gjithë anëtarët e UCTE dhe ETSO, si dhe pjesëmarrësit në asociacionet tjera. ENTSO-E është organizuar si asociacion vullnetar ndërkombëtar, ku rolin kryesor në vendim marrje do të ketë Asambleja e Përgjithshme, ndërsa aspektin operativ e menaxhon Komiteti Drejtues në krye me Kryesuesin.


ENTSO-E (European Network of TSO – Electricity) është organizatë e posathemeluar në të cilën do të shkrihen funksionet e UCTE (Union for Coordinated Transmission of Electricity), ETSO (European Transmission System Operators) dhe disa asociacioneve tjera.

ENTSO-E është themeluar me qëllim që t'i paraprijë dhe të krijoj kornizë operative për t'i përmbushur obligimet dhe kërkesat që pritet të dalin nga Pakoja e 3-të legjislativ e Bashkimit Evropian për sektorin e energjisë.

Qëllimi kryesor në themelimin e ENTSO-E është që të ketë një organizatë ombrellë e cila do të lehtësonte koordinimin në aspektin operativ, zhvillimor dhe atë të tregut, dhe do të ishte në gjendje të veproj shpejt përballë sfidave energjetike në Evropë.

Objektivë e ENTSO-E është të promovoj operimin e sigurtë, të besueshëm dhe evoluimin teknik të Rrjetit Evropian të transmissioinit të energjisë elektrike dhe të përmbushë nevojat e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike.

ENTSO-E në aspektin funksional është organizuar në tri Komitete, Komiteti për Zhvillim të Sistemit, Komiteti për Operim të Sistemit dhe Komiteti i Kornizës së Tregut. Secili komitet ka grupet funksionale dhe grupet regjionale nëpër të cilët janë shpërndarë funksionet përkatëse. (shihni më poshtë skemën organizative funksionale të ENTSO-E).



Aktualisht KOSTT nuk është përfshirë në ENTSO-E për shkak se nuk ishte anëtarë në asociacionet themeltare të ENTSO-E, për çka pengesë e vazhdueshme ishin obstrukcionet e operatorit serb EMS.

Me themelimin e ENTSO-E, asociacionet tjera relevante ku KOSTT kishte filluar proceset e anëtarësimit do të shuhen, dhe me këtë do të rrezikohet pjesëmarrja e KOSTT në proceset e integritimit rajonal, e që është objektivi kryesor i Traktatit për krijimin e Komuniteti të Energjisë në EJJ.

Për më tepër, të përballuar me obstrukcionet me qëllime politike KOSTT që nga themelimi ka ndërmarrë një varg hapash dhe veprimesh për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë në organizmat rajonale dhe evropiane.

Me synim të arritjes sa më të shpejtë të anëtarësimit në ENTSO-E është duke u përgatitur një plan detal veprues i cili përshkruan hapat konkret për arritjen e këtij qëllimi, si dhe përmbushjen e kriterëve të nevojshme teknike. Por është me rëndësi të theksohet se për të arritur këto qëllime përkrahja politike nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare prezentë në Kosovë është thelbësore.

Prandaj, KOSTT ka organizuar tryeza pune për palët e interesit për të shpjeguar planin veprues dhe për të siguruar përkrahje për këtë çështje me rëndësi, e cila besojmë se me një angazhim të shtuar të të gjitha palëve të interesit do zgjidhet në të mirë të KOSTT.

Për informata më të hollësishme rreth ENTSO-E vizitoni: www.entsoe.eu



Nga e majta (Blerim Rexha, zv.ministër i Energjisë dhe Minierave, Fadil Ismajli, drejtor menaxhues KOSTT, Ymer Balla, drejtor i përgjithshëm OSTSh, Florian Bulica, Sekretar i parë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë)

Nënshkruhet Marrëveshja e Interkoneksionit në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri si dhe Marrëveshja për implementimin e projektit të linjes interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri

Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm dhe formalizimit të bashkëpunimit në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri me 30 janar 2009, në Prishtinë është lidhur marrëveshja e interkoneksionit, përmes së cilës vendosen parimet e operimit dhe mirëmbajtjes së interkoneksionit ekzistues si dhe zhvillimit të interkoneksioneve të reja. Kjo marrëveshje gjithashtu përcakton bazat dhe mënyrën e eksploatimit optimal të linjave dhe mundëson vendosjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve ndihmëse.

Gjithashtu, në vazhden e punës rreth Linjës interkonektive në mes të dy vendeve, u nënshkrua marrëveshja për implementimin e projektit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-

Shqipëri përmes së cilës , përcaktohen raportet e ndërsjella në mes të dy operatorëve në implementimin e projektit, dhe mekanizmat për menaxhimin efikas të tij.

Projekti për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri konsiston në ndërtimin e një linje të tensionit të lartë 400 kV me gjatësi rreth 238 km, prej së cilës 85.5 km në territorin e Kosovës dhe 153.5 km në territorin e Republikës së Shqipërisë. Projekti planifikohet të fillojë brenda vitit 2009 dhe kohëzgjatja e projektit është 20 muaj.

Ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri do të ndikojë në optimizimin e dy sistemeve, ngritjen e kapaciteteve transmetuese, si dhe ngritjen e

sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe Shqipërisë, dhe po ashtu do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike. Ndërtimi i linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, do të mundësojë shkëmbimin më të madhë të energjisë në mes të dy vendeve sidomos pas ngritjes së kapaciteteve gjeneruese të planifikuara në Kosovë të bazuara në linjit si dhe të kapaciteteve gjeneruese hidro të Shqipërisë.



Aprovohen tarifat e ngarkesës për KOSTT sh.a për vitin 2009

Pas dorëzimit të aplikacionit përfundimtar për shqyrtimin e tarifave nga KOSTT me datën 18 janar 2009, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka analizuar dhe shqyrtuar përfundimisht aplikacionet dhe ka marrë vendimin për

Aprovimin e tarifave të transmisionit për tu aplikuar nga KOSTT nga data 1 prill 2009

Tariff Group	Voltage level of connection	Tariff elements	Unit	2009 Approved
Generator	400 kV / 220 kV	Use of system (capacity) charge	€/kW /year	0.000
		System operator charge	€/MWh	1.067
		Market operator charge	€/MWh	0.020
Generator	110 kV	Use of system (capacity) charge	€/kW/year	0.000
		System operator charge	€/MWh	1.067
		Market operator charge	€/MWh	0.020
Generator	Distribution	Use of system (capacity) charge	€/kW /year	0.000
		System operator charge	€/MWh	0.328
		Market operator charge	€/MWh	0.020
Supplier	400 kV / 220 kV	Use of system (capacity) charge	€/kW/year	4.636
		System operator charge	€/MWh	1.067
		Market operator charge	€/MWh	0.020
Supplier	110 kV	Use of system (capacity) charge	€/kW/year	10.094
		System operator charge	€/MWh	1.067
		Market operator charge	€/MWh	0.020

KOSTT vazhdon procesin e vendosjes së sistemit të standardizuar të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008


Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a, ka filluar procesin e vendosjes dhe zbatimit të menaxhimit të kompanisë dhe organizimit të punës, bazuar në standardin ndërkombëtar ISO 9001:2008 dhe është e përkushtuar që të punojë drejt çertifikimit.

Derisa KOSTT ka filluar dukshëm më herët me procesin e organizimit të punës bazuar në këtë standard, në kuadër të avansimit të përgatitjeve për implementim, një numër i punonjësve të KOSTT kanë ndjekur kursin "Njohja me ISO 9001:2008, menaxhimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe vlerësimi i



brendshëm sipas ISO 9001:2008. Ky grup i punonjësve të KOSTT, pas testeve që u nënshtruan, u pajisën me diploma për kompletimin me sukses të kursit dhe provimit, për auditor të brendshëm për QMS 9001:2008.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njoftuan më për së afërmi me kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë, me mjetet dhe metodat e cilësisë, menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacionit si dhe auditimin e brendshëm sipas këtij standardi.



Sistemi Elektroenergetik i Republikës së Kosovës

Prezantohen planet për zhvillimin afatmesëm të kapaciteteve të transmisionit

Në muajin mars të këtij viti, KOSTT prezantoi para palëve të interesit planet për zhvillimin afatmesëm të kapaciteteve të transmisionit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të planit të prezantuar, me implementimin e projekteve që janë planifikuar si dhe përfundimit të atyre në implementim, deri në fund të vitit 2009 do të kemi rritje të dukshme të kapaciteteve bartëse prej 930 MW në 1250 MW.

Ndërkaq, gjatë periudhës 2010-2012 me vazhdimin e përf forcimeve të rrjetit të

transmisionit bazuar në planin zhvillimor, në fund të vitit 2012, kapacitetet bartëse do të rriten nga 1250 MW në 1600 MW. Këto kapacitete janë në dispozitim gjithnjë duke konsideruar që të gjitha elementet e sistemit janë në operim.

Në rastin kur ndonjëri nga elementet e sistemit shkyçet nga rrjeti, gjë që paraqet praktikë në çdo sistem të transmisionit, atëherë kapacitetet e transmisionit bien ndieshëm.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të prezantohen kapacitetet aktuale të transmisionit dhe sa përmbushen kërkesat aktuale,

cilat janë planet për zhvillimin afatmesëm të kapaciteteve të transmisionit të Republikës së Kosovës si dhe benefitet e projekteve të implementuara dhe ato në implementim.

Në fund të vitit 2009, kapacitetet bartëse do të rriten nga 930 MW në 1250 MW

Përfundon projekti për riparimin e linjës 110 kV NS Deçan-NS Gjakovë

Në kuadër të përkushtimit të KOSTT për zhvillimin e rrjetit të transmisionit të Republikës së Kosovës, gjatë muajit prill dhe maj 2009 u implementua projekti për ndrimin e përçuesve të linjës 110 kV (kilovolt) LP 126/1 që lidhë Nënstacionin NS Deçani me NS Gjakova.

Ky projekt në vlerë prej 1.079.925.00 Euro i cili u financua nga buxheti i KOSTT, ka si qëllim eliminimin e fyteve të ngushta në rrjetin e transmetues, e me këtë sigurimin e furnizimit më kualitativ nga aspekti i transmisionit në Rajonin e Dukagjinit .



Takim i bashkëpunimit teknik në mes të KOSTT sh.a dhe Transmisionit të Malit të Zi TSO-EPCG

Një delegacion i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a., në krye me drejtorin menaxhues z.Fadil Ismajli, vizituan Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Malit të Zi, TSO-EPCG në shkurt të këtij viti.

Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i përvojave në mes të dy kompanive simotra, me ç'rast u zhvilluan edhe diskutime për disa çështje teknike me interes të dyanshëm si dy sisteme fqinje si:

- Akordimi i planeve të mirëmbajtjes së linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Mali i Zi.
- Raportet në mes të dy Qendrave Nacionale Dispeçerike-shkëmbimi i përvojave

- Çështja e matjeve të energjisë elektrike që rrjedh në rrjetin e transmisionit, sidomos pas aktivizimit të Nënstacionit në ndërtim 400/110 kV Peja 3
- Shtrirja e fibrit optik nga të dy anët, si dhe menaxhimi i të dhënave që do rrjedhin në të dhe,
- Informimi i dyanshëm mbi planet e zhvillimit të kapaciteteve të reja transmetuese me theks në kapacitetet interkonektive si: nga ana e Malit të Zi - Linja interkonektive Mali i Zi-Shqipëri dhe kablo nënujore Mali i Zi-Itali, si dhe nga ana e Kosovës - Linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, si dhe linja e dytë 400 kV Kosovë-Maqedoni.

Sikurse drejtori menaxhues i KOSTT sh.a, z.Fadil Ismajli po ashtu edhe drejtori i Transmisionit të Republikës së Malit të Zi, TSO-EPCG, z. Zoran Djukanoviq, u shprehën të kënaqur me takimin dhe shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm në mes të dy kompanive.

Po ashtu, homologët u pajtuan për themelimin e grupeve punuese për çështjet teknike të diskutuara.



Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit ekzistues, KOSTT realizon mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit transmetues

KOSTT ka trashëguar një rrjet të transmisionit relativisht të vjetër dhe me kapacitet të kufizuar, ndërtimi i së cilës është zhvilluar në mes të viteve 1953-1988.

Që nga viti 1990 kur regjimi serb e mori kontrollën mbi industrinë energjisë elektrike në Kosovë e deri në vitin 2003, në rrjetin e transmisionit nuk ka pasur investime reale.

Me qëllim të arritjes së hapit të humbur në mungesë të investimeve për më shumë se një dekadë, e cila pasqyron edhe situatën politike gjatë okupimit serb të Kosovës, KOSTT sh.a punon me një tempo të shpejtuar në zhvillimin e

projekteve për të cilat kërkohet kohë për tu implementuar, me qëllim të *ngritjes së kualitetit të shërbimeve*.


Janë implementuar si dhe aktualisht janë në implementim shumë projekte të cilat do të ndikojnë dukshëm në rritjen e besueshmërisë dhe stabilitetit të Sistemit Elektroenergetik të Kosovës, modernizimin e tij si dhe rritjen e kapaciteteve bartëse.

Në anën tjetër, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit ekzistues, KOSTT realizon *mirëmbajtjen* e rregullt mujore dhe vjetore të rrjetit ekzistues, gjë që ka rezultuar me zvogëlimin e rënieve,

intervenimeve, dhe furnizimit më kualitativ me energji elektrike nga aspekti i transmisionit.

Vetëm gjatë vitit 2008 është arritur që prishjet në linjat e transmisionit të zvogëlohen për rreth 31.77%.

KOSTT ka trashëguar një rrjet të transmisionit relativisht të vjetër dhe me kapacitet të kufizuar, ndërtimi i së cilës është zhvilluar në mes të viteve 1953-1988



Amandamentohet Neni 3.2 dhe Neni 17.4.2.2 i Kodit të Pajisjeve Elektrike

Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale-KQKO, në takimin e mbajtur me 11 shkurt 2009, në bazë të mandatit të definuar me Procedurat e Menaxhimit të Kodeve Teknike / Operacionale, të aprovuara nga ZrrE, ka shqyrtuar propozimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a për amandmimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike.

Anëtarët e KQKO-së, kanë analizuar me kujdes propozimet për ndryshime

dhe pa kundërshtime kanë vendosur që të përcjellin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, kërkesën për ndrrimin e parametrave në Nenin 3.2, si dhe ndrrimin e parametrave në Nenin 17.4.2.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike.

Bazuar në propozimin dhe arsyeshmërinë e prezantuar nga KOSTT, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë -ZRrE në takimin e mbajtur me 1 prill 2009, ka marrë vendim për

amandmimin e Nenit 3.2 dhe të Nenit 17.4.2.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike.

Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale është një trup i themeluar në bazë të Procedurave për menaxhimin e Kodeve Teknike/Operacionale të aprovuara nga ZRrE, ku janë të përfaqësuara të gjitha palët relevante që operojnë sektorin e energjisë në Kosovë.



Vendimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) gjatë muajve Janar, Shkurt, Mars dhe Prill 2009

Tarifat e reja të transmisionit aplikohen nga data 1 prill 2009

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 27 shkurt 2009, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim që ti lejohet KOSTT sh.a derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit sipas afateve të caktuara. (V_160_2009)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 1 prill 2009, në bazë të kërkesës së dorëzuar nga KQKO, ka marrë vendim që të lejohet amandmimi i Nenit 3.2 dhe Nenit 17.4.2.2 i Kodit të Pajisjeve Elektrike (V_163_2009)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 15 prill 2009, në bazë të kërkesave të KOSTT për shqyrtimin e tarifave të transmisionit ka përcaktuar dhe marrë vendim për tarifat dhe ngarkesat e transmisionit që do të zbatohen nga data 1 prill 2009. (V_172_2008)

Panairi Ndërkombëtar i Teknologjisë dhe Cilësisë

Alb-Konfindustria, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë dhe partnerët institucional të saj në Bashkimin Europian kanë organizuar Panairin Ndërkombëtar të “Teknologjisë dhe Cilësisë 2009”, që u mbajt në Tiranë prej 29 prill deri më 1 maj. Në Panair ishin të përfaqësuara vetëm sipërmarrjet më të mira/fuqishme të prodhimit dhe shërbimit.

Kompani me influencë nga Kosova, Shqipëria si dhe kompani ndërkombëtare, ishin prezente në panair, ngjarje e cila për dallim nga viti i kaluar kishte interesim më të madhë nga vizitorët dhe po ashtu kompanitë që prezentoheshin në panair ishin shumë më të përgatitura dhe disa prej tyre edhe me prezente shumë të veçanta e spektakulare.

Në kaudër të Panairit Ndërkombëtar të Teknologjisë dhe Cilësisë u mbajt edhe Forumi i Energjisë “Shqipëria si fuqi energjetike” në kuadër



Fadil Ismajli, drejtor menaxhues KOSTT, Justina Shiroka-Pula, ministre e Energjisë dhe Minierave dhe Ymer Balla, drejtor i përgjithshëm OSTSh

të së cilës drejtori menaxhues i KOSTT, z.Fadil Ismajli, mbajti prezentimin me titull “Mundësia e krijimit të tregut të përbashkët të Energjisë Elektrike Kosovë-Shqipëri”.

Në Forumin e Energjisë në kuadër të Panairit, ku ishin prezent përveq kompanive të shumta energjetike vendore dhe ndërkombëtare ishin prezent

po ashtu edhe ministrja e Energjisë dhe Minierave e Kosovës znj. Justina Shiroka-Pula, si dhe ministri i Energjisë së Shqipërisë z.Genc Ruli. Ngjarja është përcjellur dhe mbuluar nga media të shumta në Kosovë dhe Shqipëri.



Lajm Shkurt

Konstituohet Bordi i Drejtorëve të KOSTT sh.a

Me 2 qershor 2009, u mbajt takimi i parë i Bordit të Drejtorëve të KOSTT në përbërje prej: z.Faton Deda, kryesues, z.Fadil Ismajli, anëtar-drejtor menaxhues i KOSTT, z.Fadil Rrustemi, anëtar, z.Fatos Ukaj, anëtar, z.Lutfi Maxhuni, anëtar, z.Nazmi Mikullovi, anëtar dhe z.Ramadan Paçarada, anëtar.

Në takimin e parë konstituues, KOSTT prezantoi para anëtarëve të Bordit të Drejtorëve punën e gjertanishme të kompanisë si dhe të akteve të aplikueshme që rregullojnë veprimtarinë e KOSTT.

KOSTT në numra

Numrat të cilët e karakterizojnë veprimtarinë e kompanisë

- 1 Qendër Nacionale Dispeçerike
- 1 Linjë interkonektive 220 kV me Shqipërinë
- 1 Linjë interkonektive 400 kV me Maqedoninë
- 1 Linjë interkonektive 400 kV me Malin e Zi
- 4 Linja interkonektive (1-400 kV, 1-220 kV dhe 2-110 kV) me Serbinë
- 3 Nivele të tensioneve me të cilat operon KOSTT sh.a (niveli 400, 220 dhe 110 kV)
- 3.49 km linja më e shkurtër 110 kV që lidh NS “Kosova A” me NS Bardhi
- 7 Linja interkonektive me shtetet fqinje
- 10 Transformatorë në pronësi të KOSTT
- 20.9 % e punëtorëve janë të gjinisë femërore
- 29 Nënstacione
- 31.77% janë zvogëluar prishjet në krahasim me vitin 2007
- 38 % Inxhinier
- 43 Moshë mesatare e punëtorëve të KOSTT
- 50 % e punëtorëve me përgatitje superiore profesionale
- 70.95 km linja më e gjatë 400 kV Kosovë-Serbi (pjesa e linjës brenda Kosovës)
- 79.1 % të punëtorëve janë të gjinisë mashkullore
- 181.4 km gjatësia e linjave 400 kV
- 201 Punëtorë
- 231.82 km gjatësia e linjave 220 kV
- 645 km gjatësia e linjave 110 kV
- 930 MW kapacitetet bartëse të KOSTT
- 967 MW transmetimi rekord i energjisë i realizuar me 17 shkurt 2008
- 1058.22 km gjatësia e përgjithshme e linjave
- 3000 MVA kapacitete transformuese
- 8562.544 GWh energji ka hyrë në rrjetin e transmisionit gjatë vitit 2008
- 26 000 000 Euro-vlera e projekteve investuese të realizuara gjatë vitit 2008
- 219.363.000 Euro-vlera e planifikuar e investimeve sipas PZhST 2009-2013



Ngjarje të ardhshme relevante vendore/ndërkombëtare

*3-4 qershor 2009
Budapest, Hungari*

- **Konferenca: Tregtimi me Energji në Evropën Qendrore dhe Jug-lindore**
- Organizuar nga: Synergy a Clarion Events company

*18-19 qershor 2009
Selanik, Greqi*

- **Konferenca –Dialogu i 3^{të} i Energjisë në EJL**
- Organizuar nga: IENE

*22-24 qershor 2009
Vienë, Austri*

- **Forumi Global për Energji të Qëndrueshme**
- Organizuar nga: UNIDO, IIASA, ADC dhe AEA

- Buletini është publikim i KOSTT sh.a, Sektori për Komunikim, Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative,
- Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
- Tel: +381(0) 38 501 601 174 ; email: info@kostt.com
- Web: www.kostt.com
- Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:
Zana Bajrami-Rama, menaxhere për komunikim
zana.rama@kostt.com

